



ARGUMENTATION – EVIDENTIARY PROCEDURE IN CRIMINAL PROCEEDINGS

Valon Mehmeti
Lawyer.Ll.M
info.valonmehmeti@gmail.com

DOI: 10.2478/seeur-2018-0005

ABSTRACT

The continuous increase in criminal activities in all countries, namely the offences which undermine the interests of contemporary societies, call for the need to fight them in a more successful manner. In this way, the country through its mechanisms detects the criminal offences, the criminal liability and imposes the meritorious sanction to the perpetrators of such criminal offences, in full compliance with the danger caused by them. However, the court and other parties in the proceedings (Prosecution, Lawyer, Victim's Advocate) in any case before the sanction is imposed, are involved in a complicated evidentiary proceedings related to the grounded suspicion that such offence was a criminal offence, the special mitigating and aggravating circumstances, that the person involved was conscious, that he committed the offence intentionally or negligently, his mental state, etc. All these have to be supported by facts through conclusive pieces of evidence.

In parallel with the overall development of science and technology, the evidentiary procedure has evolved and it provides a greater possibility to argue our facts. This paper shall make efforts to highlight some of the most important issues related to the evidentiary procedure, such as: What is the evidence? What evidence should be provided in a certain criminal case? What is the importance of the evidence in a criminal matter? What should be the credibility and the evidentiary value of a piece of evidence? The research done in this paper shall apply the analytical method and the paper shall also include the conclusions that were reached as well as the recommendations.

Key words: Evidence, procedure, truth, trial, sanction, etc.

ARGUMENTIMI - TË PROVUARIT NË PROCEDURË PENALE

ABSTRAKT

Rritja e vazhdueshme e aktiviteteve kriminale në të gjitha shtetet, vepra këto me të cilat minohen interesat e shoqërive bashkëkohore, paraqet domosdoshmërinë e një luftimi dhe parandalimi më të suksesshëm të sajë. Kjo bëhet në atë mënyrë që shteti përmes mekanizmave të tij, zbulon veprat penale, përgjegjësin penale dhe u shqipton sanksionin meritor kryerësve të këtyre veprave, në përputhje të plot me rrezikun e shkaktuar me ato. Mirëpo, gjykata dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë (Prokurori, Avokati, Përfaqësuesit e viktimave etj.), në çdo rast para shqiptimit të sanksionit përfshihen në një proces të ndërlikuar të provuarit lidhur me dyshimin e bazuar se vepra e tillë ka qenë vepër penale, rrethanat e veçanta lehtësuese e rënduese të asaj veprë, se personi në fjalë është i përgjegjshëm, se veprën a e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia, gjendja e tij mentale, etj. Gjithë këto duhet t'i mbështesin në fakte të provuara në mënyrë bindëse.

Krahas zhvillimit të gjithmbarshëm të shkencës dhe teknologjisë ka evoluar edhe procedura e të provuarit, çka na ofron edhe një mundësi më të madhe për të argumentuar faktet tona. Në këtë punim, do të bëjë përpjekje të spikati disa nga çështjet më të rëndësishme lidhur me të provuarit, si: Çfarë janë provat? Çfarë duhet të provohet në një rast konkret penal? Cila është rëndësia e të provuarit të një çështje penale? Çfarë duhet të jetë: Besueshmëria dhe fuqia provuese e një prove? Hulumtimit të këtij punimi, do t'i qasem përmes aplikimit të metodës analitike. Punimi do të përmbajë gjithashtu konkluzionet e arritura dhe rekomandimet.

Fjalët kyçe: provë, procedurë, e vërteta, gjykim, ndëshkim, etj.

HYRJE

Nëse e bëjmë një vështrim të shkurtër lidhur me procedurën e të provuarit në periudha të ndryshme kohore, kuptojmë se kanë ekzistuar rrugë, mënyra e metoda të ndryshme për gjetjen e saj në procedurë penale, duke filluar nga format më primitive të zbardhjes së vërtetës e deri në format më moderne. Fal zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik-shkencor dhe teknologjik, janë shfaqur edhe forma moderne për arritjen e së vërtetës në procedurë penale, çka ka bërë që në masë të madhe të lehtësohet arritja deri tek e vërteta objektive. Sot, pavarësisht këtyre divergjencave në të provuar, qëllimi ka mbetur gjithherë i njëjtë, e ai është gjetja e së vërtetës në procedurë penale.

Të provuarit në procedurë përbën shtyllën kryesore për një gjykim të drejtë e të ligjshëm, i cili në pjesën dërmuese të shoqërive bashkëkohore është paraparë edhe si një nga parimet kryesore në procedurë penale. Është e një rëndësie jetike që në procedurë gjyqësore të arrihet vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, në të cilat do të mbështetëj vendimi gjyqësor. Pasi që edhe vetë çështjet për të cilat vendoset në procedurë penale janë të lidhura me interesin e përgjithshëm, dhe shpeshherë me të kufizohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Mirëpo, të jemi

korrekt, gjetja e së vërtetës absolute është diçka iluzore për tu arritur, e në praktikë një realitet i pamundur. S' do mend se qëllimi është që në procedurë të arrihet e vërteta e plotë objektive, e cila do të konsistonte në përputhshmërinë e plotë të gjykimeve tona, me parafytyrimet tona mbi ngjarjet e kaluara, ose mbi gjendjen e tanishme, gjatë gjykimit në një instancë gjyqësore, e cila do të evitonte mundësinë e shfaqjes të së kundërtës. Përkundër arritjeve në teknologji e shkencë argumentimi i plotë është një çështje e vështirë e shpesh edhe e pamundur çka përbën një problematikë shqetësuese karshi lirive të qytetarëve. Përkundër rëndësisë që ka zbardhja e së vërtetës në secilin rast konkret gjykata dhe pjesëmarrësit tjerë procedural nuk mund të shërbejnë me çfarëdo mjeti të provave. Ata mund të përdorin vetëm ato prova që janë të lejuara me ligj, apo ato të cilat dalin nga parimet dhe fryma e normave procedurale. Disa indikator që e bëjnë edhe më të vështirë argumentimin në procedurë janë edhe vet kriminelët e ndryshëm, të cilët gjatë aktivitetit të tyre kriminal, i shfrytëzojnë të arriturat shkencore dhe aftësitë e ndryshme për të penguar të provuarit e drejt. Problematikë tjetër paraqitet edhe vetë qëllimi bashkëkohor i procedurës penale. Kjo, për faktin së mbështetet në dy parime antagoniste: 1. Në suksesin e procedurës penale dhe 2. Në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Parime të cilat vazhdimisht e kundërshtojnë njëra-tjetrën, mirëpo duhet pasur kujdes se favorizimi i njëres bëhet në kurriz të tjetrës e në këtë mënyrë ndikohet që të nxjerrën vendime të ndryshme arbitrare. Gjithsesi këtu duhet pasur parasysh ndalesat e caktuara që i referohen ruajtjes së integritetit të individit, mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tij të garantuara me akte ndërkombëtare dhe me dispozita të brendshme. Krahas një numri të madh të provave, të cilat mund të paraqiten në një rast konkret, do të ishte e dëshirueshme që gjykata dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë (Prokurori, Avokati e përfaqësuesit tjerë ligjor), të kenë njohuri adekuate nga fusha e psikologjisë gjyqësore, si parakusht i rëndësishëm për të njohur rrjedhën e plotë të seancës gjyqësore, e sidomos çmuarja e provave të bëhet jo vetëm në një shkallë të lartë të bindjes personale, mirëpo qëndrimet dhe vendimet të kenë edhe mbështetje profesionale.

ÇKA JANË PROVAT?

Me provë - argument në procedurë penale kuptojmë çdo të dhënë, e cila në procedurë gjyqësore flet për saktësinë e ndonjë fakti relevant. Provat janë burim njohurish për faktet, që vërtetohen në procedurë penale, të cilat i përdor organi që i vërteton ato. Provat i hasim gjatë gjithë rrjedhës së procedurës gjyqësore.¹ Para se gjykata të vendos për një çështje konkrete duhet të krijoj bindje të plotë e kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet provave të plota e të besueshme, të marra në mënyrë të rregullt, përmes të cilave bëhet zbardhja e rastit konkret, duke u mbështetur gjithëherë në frymën e parimeve të procedurës penale bashkëkohore. Prova, pra shërben si një udhërrëfyes për gjetjen e së vërtetës, e cila pasqyron një realitet të së shkuarës, të cilin gjykata dhe pjesëmarrësit tjerë procedural e shfrytëzojnë për të mbështetur qëndrimet e tyre lidhur me vërtetimin e ndonjë fakti, apo kundërshtimin e faktit të pjesëmarrësit tjetër.

Ndriçimi dhe zgjidhja e çështjes penale në procedurë kupton ndërmarrjen e një mori veprimesh procedurale me ndihmën e të cilave, vërtetohen rrethanat e ngjarjes në përputhje me ndodhitë reale nga e kaluara, me ndihmën e të cilave gjykata duhet të gjejë të vërtetën në procedurë penale. Realizimi i këtij qëllimi themelor procedural, që në realitet paraqet shkallën më të lartë të sigurisë për të vërtetën që mund të arrihet në procedurë penale, kërkon që të vërtetohen faktet relevante juridike. Vërtetimi i këtyre fakteve në procedurë penale arrihet përmes provave.² Provat e paraqitura nga pjesëmarrësit procedural deponohen në

¹ Ejup Sahiti - Rexhep Murati, "E drejta e Procedurës Penale", Prishtinë, 2013, fq.230.

² Ejup Sahiti, "Argumentimi në Procedurë Penale" Prishtinë, 2006, fq.107.

gjykatë dhe vërtetësia e tyre rishikohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe atë me perceptim personal të vetë gjyqtarit, apo anëtarëve të trupit gjykues, por si parakusht paraqitet që prova e propozuar para procedimit të ketë një relevancë të caktuar lidhur me rastin, e më pas ajo vlerësohet si e pranueshme apo e pa pranueshme. Historikisht, prova e një krimi ka qenë mjaft e qartë. Kontestet e mesjetës së hareshme dhe asaj mesjetare në Evropë zgjidheshin nga kryetari i komunitetit, ose nga përfaqësuesit e mbretit. Akuzat ndaj një personi mbështeteshin nga një dëshmitar nën betim. Kjo njihej si “provat irracionale” ose të pa arsyetuara, vërtetimi i një krimi që mbështetej nga betimi, ose sprova. Akuza mund të mbështetej edhe nga “ndihmësit e betimit”, të cilët ishin njerëz që nuk ishin dëshmitar, por e jepnin betimin në mbështetje të akuzës. Kjo ka qenë kryesisht si një mënyrë për tu siguruar se komuniteti e përkrahte gjykimin përfundimtar dhe jo për të përcaktuar faktet e sakta. Mirëpo, sot provat janë shndërruar në “racionale” dhe të arsyetuara. Kjo nënkupton se prova ndërlidhet logjikisht me akuzën, prandaj saktësia e provave përbën një element shumë më të rëndësishëm.³

ÇFARË DUHET TË PROVOHET NË NJË RAST KONKRET PENAL - RELEVANCA?

Pas inicimit të procedurës gjyqësore- pas ngritjes së aktakuzës dhe kalimit të çështjes në gjykatë, subjektet procedural (gjykata, prokurori, avokatët, përfaqësuesit ligjor, etj), duhet të kenë një pasqyrë të qartë lidhur me faktet, të cilat duhet të provohen në rastin konkret. Pavarësisht se qëllimi i gjykimit është gjetja e së vërtetës në procedurë penale, subjektet procedural kanë pozicione të ndryshme me njëri-tjetrin. Kjo konsiston në atë se p.sh. provat të cilat i paraqet prokurori shpeshherë mundohen të zhvleftësohen nga avokatët mbrojtës, apo edhe e kundërta. Në atë mënyrë që përderisa prokurori i sheh provat dhe pohimet e parashtron hipotezë se si i pandehuri ka kryer krimin. Avokati mbrojtës ofron teori alternative me anë të të cilave mundohet të largoj fajësinë nga klienti i tij. Subjektet procedural shpeshherë janë të prirë që të identifikojnë prova të kundërta me qëllim që të jenë më efikas karshi subjekteve tjerë procedural.

Juristi në çdo rast konkret duhet të konsideroj se çfarë duhet të vërtetohet, me qëllim të gjetjes së vërtetës në çështje penale. Fokusimi në gjetjen e provave relevante dhe asaj se çka duhet të provohet përbën një nga objektivat më të rëndësishme për një gjykim të suksesshëm. Relevanca e pjesës së provave varet krejtësisht nga ajo se çfarë duhet të vërtetohet. Ajo quhet edhe materialitet. Nëse provat nuk e rrisin apo ulin probabilitetin e konkluzionit të përkohshëm, ose të objektivit përfundimtar, atëherë nuk janë relevante. Me fjalë të tjera provat duhet të ndikojnë tek disa konkluzione, apo vendime të rëndësishme për rastin.⁴ Juristët duhet të jenë të kujdesshëm më rastin e zgjedhjes së asaj se çfarë duhet të provohet në rastin konkret dhe ata shpeshherë gjenden përballë disa çështjeve të cilat kërkojnë të provohen si parakusht për gjetjen e së vërtetës në procedurë, ato janë: çfarë lidhshmërie ka prova konkrete me krimin? Çfarë prove duhet të paraqitet për të argumentuar fajësinë e të akuzuarit? Çfarë prove duhet paraqitur për të provuar pafajësinë e të akuzuarit? Çfarë arsyes mund të provojnë një dënim më të rënd, apo më të butë në rastin konkret? Çfarë prove t'i ofrojmë gjykatës të vërtetojmë rrethanat rënduese apo fajësuese? Përballë këtyre dhe shumë pyetjeve tjera gjenden subjektet procedural të një çështje penale, të cilët duhet të jenë të kujdesshëm më rastin e vlerësimit se çka duhet të provohet në rastin konkret dhe se prova e

³ Jon Simbert, “Parimet e Provave”, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2014, fq. 17.

⁴ Ibid. fq.83.

paraqitur a është relevante në atë rast apo jo. Për të qenë një provë relevante ajo duhet të ketë lidhshmëri të caktuar me krimin.

Shembull: tek biznesi, i cili ka kryer veprën penale të shmangies nga pagimi i tatimit, në zyrën e drejtorit të këtij biznesi gjendet një revole pa leje! Nuk mund të arrihet në përfundime që kjo revole ka qenë rezultat i kryerjes së veprës penale, për faktin që nuk ka lidhshmëri me veprën e evazionit fiskal. Çka nënkupton se kjo provë nuk është relevante karshi rastit konkret. Pra secila palë në procedurë duhet në rend të parë të dijë çka duhet të provoj. Provat pra ndërlidhen me qëllimet e palës në rastin konkret dhe ato duhet të jenë relevante për rastin. Provat duhet të jenë relevante për të qenë të pranueshme. Që prova të jetë e rëndësishme, duhet të ketë një lidhje logjike mes saj dhe faktit që është ofruar për ta provuar, apo përgënjeshtuar.

Shembull: rasti Lanc Sellot është akuzuar për ngasjen e veturës në gjendje të dehur. Prokuroria ofron dëshmi se Lance është anëtar i një bande të dhunshme në rrugë. Në rastin konkretë dëshmia është e parëndësishme apo jo-relevante lidhur me rastin konkret, sepse krimi, i cili ngarkohet nuk ka të bëjë me aktivitetet e bandës. Provat e tilla shërbejnë vetëm si paragjykim, mirëpo si të tilla janë jo-relevante sepse nuk kanë lidhshmëri me rastin konkret.

Shembull: rasti Clare Voyant është akuzuar për vjedhjen e makinave. Ajo më pas arrestohet në shtëpinë e saj dhe prokuroria ofron dëshmi se oficerët gjatë arrestimit kanë gjetur marihuanë dhe një pistolet të paregjistruar. Përveç nëse prokuroria mund të gjejë prova se arma dhe droga ishin të përfshira në një farë mënyre në vjedhje, nuk ka asgjë për ti lidhur ato me krimin e vjedhjes së makinave. Provat e tilla përsëri nuk do të konsideroheshin relevante, për shkak se nuk kanë lidhshmëri konkrete me veprën për të cilën akuzohet personi i caktuar. Pra nga gjithë kjo mund të arrijmë në përfundimin se prova duhet të ketë lidhje me veprën penale konkrete, si premisë që të ketë shanse të pranueshmërisë së saj nga gjykata, por jo të gjitha provat janë të pranueshme dhe mund të përdoren në një gjykim penal.⁵

CILAT JANË PROVAT MË INKRIMINUESE NË PROCEDURË PENALE?

E vërteta materiale, nënkupton vërtetimin e plot të të gjitha fakteve relevante juridike nga të cilat varet zbatimi i të drejtës penale materiale dhe procedurale, duke e përputhur gjendjen faktike të vërtetuar në procedurë penale, me ngjarjen reale nga e kaluara, e cila është kualifikuar si vepër penale.⁶ Është e padiskutueshme se për të arritur deri tek kjo e vërtet gjykata përdorë mjete e burime të ndryshme të provave. Çështja e të provuarit ka evoluar në masë të madhe nga e kaluara e deri në ditët e sotme. Për dallim nga kohët e vjetra, ku shtetet gjykimin e kanë mbështetur në prova irracionale dhe të paarsyetuara, si: në betimin e të pandehurit, betimin me bashkë betarë, në dëshminë e dy dëshmitarëve, torturën si mjet të provës, e cila metodë fatkeqësisht është përdorur deri vonë, gjyqi hyjnorë, etj. Sot, gjykimi i shoqërive lidhur me një vepër penale, mbështetet në prova racionale dhe në shumicën e rasteve të arsyetuara.

Provat paraqesin armën vendimtare për të përjashtuar të dyshuarit, gjetjen e kriminelëve dhe të provuarit të fajësisë së tyre. Shumë kriminel bëjnë përpjekje për të mbuluar krimin e tyre dhe të mos lënë asnjë gjurmë të mundshme të provave, por përparimet e mëdha në mjekësinë ligjore kanë bërë të mundur të gjenden lloje të ndryshme të provave që janë të pranueshme në

⁵ Paul Bergman, J.D, UCLA, Law School Professor, "Relevant Evidence in Criminal Trials", <http://www.nolo.com/legal-encyclopedia/relevant-evidence-criminal-trials.html#>.

⁶ Ejup Sahiti, "Argumentimi në Procedurë Penale", Prishtinë, 2006, fq.92.

gjykatë. Do t'i paraqesim vetëm disa nga llojet e provave me vlerën më të madhe inkriminuese:

1. **Shenjat e gishtërinjve:** shenjat e gishtërinjve janë llojet më inkriminuese të provave të përdorura në rastet penale, sepse kjo është një nga format më të besueshme të identifikimit. Kjo, për faktin se nuk ekzistojnë qoftë edhe dy njerëz në botë që kanë gjurmë të njëjta të gishtërinjve.
2. **Gjaku:** gjaku paraqet një provë të rëndësishme për inkriminim. AND-ja mund të nxiret nga gjaku për të ndihmuar gjetjen e kriminelit apo hetimin e personave të dyshuar.
3. **Flokët:** flokët janë një lloj tjetër i dobishëm i të dhënave që mund të sjellë policinë më afër kriminelit. Një fije floku e marrë në vendin e ngjarjes mund të dorëzohet për testimin e AND-së. Shkencëtarët e mjekësisë ligjore mund të kenë një shansë më të mirë në testimin e AND-së.
4. **Lëkura:** edhe pse lëkura është e vështirë për t'u gjendur në vendin e krimit, me anë të saj mund të analizohet dhe testohet gjetja e një krimineli. Ngjashëm me flokët, mostrat e lëkurës mund të ndihmojnë të përcaktojnë ngjyrën e lëkurës së personit të përfshirë në krim dhe AND-së, të cilat mund të nxjerren për një identifikim më të saktë të kriminelëve.
5. **Dëshmia e dëshmitarit:** dëshmia nga një dëshmitarë, i cili ishte në vendin e ngjarjes është një nga llojet më inkriminuese të provave. Sa inkriminuese është dëshmia varet nga besueshmëria e dëshmitarit, e cila është përcaktuar nga juria. Ajo mund të jetë faktori vendimtarë në një rast.
6. **Sperma:** sperma mund të përdoret në disa mënyra për të verifikuar akuzat për përdhunim si dhe AND-në për të identifikuar kriminelin. Me spermë gjithashtu mund të analizohen dhe testohen të dhëna për të përcaktuar nëse ka pasur më shumë se një person të përfshirë në një krim seksual.
7. **Shenjat e këpucëve:** shenjat e këpucëve janë jashtëzakonisht të dobishme për hetimet e policisë dhe ato mund të jenë një lloj shumë inkriminues i provave. Policia mund ndihmojë shumë nëse identifikon shenjat e këpucëve, modelin dhe madhësinë e tyre, përmes tyre kupton gjininë dhe largësinë e përafërt të personit.
8. **Videokaseta dhe fotografite:** këto janë dy llojet më bindëse dhe inkriminuese të provave. Nëse video kaseta apo fotografia janë marrë gjatë krimit ato padyshim që janë një dëshmi e vlefshme dhe ndihmojnë në largimin nga të dyshuarit dhe gjetjen e kryerësve të vërtetë.

BESUESHMËRIA DHE FUQIA PROVUESE E NJË PROVE

Çfarë na bënë të besojmë se provat janë të vërteta apo të sakta? Çfarë cilësish të pjesëve të provave e arsyetojnë atë besim? Provat në rend të parë mund të jenë “prova dëshmuese”, të cilat përbëhen nga pohime me shkrim, ose me gojë nga dëshmitari, ose “prova konkrete” që mund të përfshijnë dokumente, objekte fizike, video, fotografi, harta, diagrame e sende tjera të ngjashme.⁷

Sa i përket besueshmërisë së një “prove dëshmuese” duhet thënë se gjyqtari në çdo rast bën përpjekje të dallojë besueshmërinë e një personi që dëshmon gojariht. Gjatë dhënies së

⁷ Jon Simbert, “Parimet e Provave”, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2014, fq. 64.

dëshmisë nga ana e këtij personi gjyqtari vëren gjuhën që e përdorë ky person, shenjat e fytyrës, lëvizjet trupore, mimikën e fytyrës, pozicionin e trupit, gjendjen nervoze të personit gjatë dëshmisë, e sinjale tjera trupore, të cilat shfaqë ky person gjatë dhënies së dëshmisë. Me anë të këtyre sjelljeve gjyqtari mund të fitoj një shkallë të caktuar të besimit lidhur me dëshminë, mirëpo mund edhe ta hedh si të papranueshme. Sidoqoftë, besueshmëria në një dëshmi konkrete bazohet edhe në faktorë tjerë.

Shembull: së pari duhet kuptuar nëse dëshmitari ka bazë për të dhënë deklaratën e tillë (si bazë më e fortë për dhënien e dëshmisë së tillë do të ishte që ky dëshmitarë të ishte “dëshmitarë okular”- por dëshmi më pakë e besueshme do të ishte nëse dëshmitari nuk e ka parë vetë rastin, por ka marrë ato njohuri nga një burim tjetër). Më pas ne mund të vlerësojmë besueshmërinë e asaj prove. Gjyqtari e vlerëson besueshmërinë e asaj deklarate në varësi të njohurive personale dhe arsyeshmërisë së konkluzionit.

Çështje tjera, të cilat i merr parasysh gjyqtari kur vlerëson besueshmërinë e një dëshmie të dëshmitarit janë edhe: aftësitë e veçanta të atij dëshmitari në ditën kritike për të vëzhguar ngjarjen. Një person mund të jetë i bindur lidhur me dëshminë e tij, mirëpo duhet të verifikuar nëse ai ka pasur shikim të penguar më rastin e ngjarjeve, ose nuk ka mundur të dëgjojë për shkak të zhurmës. Nëse dëshmitari ka qenë larg nga vendi i ngjarjes deri në çfarë niveli ka arritur ta kuptoj ngjarjen? Nëse ai dëshmitarë ka shikimin e dobët (raportet mjekësor), deri në çfarë niveli ka arritur ta perceptojë ngjarjen? Nëse dëshmitari ka problem me dëgjim, sa është e vlefshme, që ai të tregoj për kërcënimet e fyerjet e ndryshme? Nëse është person i shtyrë në moshë, cila do të jetë besueshmëria e këtij personi? Nëse është fëmijë a ka mundur të kuptojë të gjithë ngjarjen? Varësisht nga rasti konkretë dhe mangësitë shqisore të këtyre dëshmitarëve, me rastin e vëzhgimit të ngjarjeve është në bindjen e lirë të gjyqtarit t’i besoj ose jo. Mirëpo për mbrojtësin e të pandehurit paraqitet një shansë, që dëshmitarët më probleme të tilla shqisore t’i konsiderojë si të pa pranueshëm. Mirëpo, nëse dëshmia e dëshmitarëve të tillë përputhet edhe me provat tjera të vërtetuara në gjykatë, kjo dëshmi merret si e pranueshme në shumicën e rasteve.

Prova konkrete - në procedurë është shembull: pistoleta e gjetur në vend ngjarje. Pistoleta nuk vëzhgon asgjë. Ajo nuk ka kapacitet të gënjej apo të paragjykoj. Pistoleta është veçse një objekt i gjendur në vend ngjarje. A përbën ky fakt një të vërtet automatikisht të besueshme. Sigurisht që jo. Madje e gjithë prova konkrete mund të ketë mungesë të besueshmërisë. Besueshmëria e provave konkrete gjithëherë matet duke e vlerësuar saktësinë apo autenticitetin e tyre. Autenticiteti paraqet masën më kritike të besueshmërisë se a është sendi vërtetë provë fizike, që është përfshirë në krim? Shembulli me i qartë i provave joautentike, do të mund të ishin dokumentet e falsifikuara ose të ndryshuara.⁸ Povat konkrete, si dokumente, shënime bankare, evidenca të telefonit, ose dëshmi fizike ndonjëherë mund të paraqiten edhe si dëshmi të pagabueshme. Mirëpo avokati kundërshtar mund të jetë në gjendje të gjejë prova që ngrenë në pyetje besueshmërinë e asaj prove konkrete. Ajo që duhet mbajtur në mend është se shumica e provave konkrete janë rezultat i ndonjë procesi. Shembull marrjen e provës nga vendi i krimit përfshinë: procesin e mbledhjes së provave, ruajtjes së këtyre provave dhe testimit të tyre. Dështimi apo menaxhimi i gabuar me rastin e marrjes së këtyre provave në vendin e ngjarjes, bëhet shkaktarë që këto prova të humbin besueshmërinë e tyre.

Shembull: polici mbledh mostra të gjakut në vendin ku është kryer krimi, por me rastin e marrjes së tyre nuk e i merr në mënyrë të duhur, pasi që të njëjtat nuk i evidenton dhe nuk i ruan si duhet. Ato gjenden të nesërmen. Pasi ato dërgohen për analizim, nuk është e sigurt nëse ato kanë ardhur nga skena e krimit. Edhe pse mostrat e gjakut përputhen me llojin e

⁸ Ibid, fq.66

gjakut të të pandehurit, por meqë provat kanë autenticitet të vogël atëherë u mungon besueshmëria.

Fuqia provuese - është e vështirë për t'u definuar në mënyrë të saktë tek provat. Ka mendime të ndryshme lidhur me atë se çka nënkupton fuqia provuese e një prove. Disa i referohen asaj si formë e "lartë" apo me e "ulët" e besueshmërisë. Disa tjerë shprehin bindjen se fuqia provuese, konsiston në atë se një provë ka "më shumë" apo "më pak" ndikim mbi vendimin përfundimtarë të gjykatës. Disa fuqinë provuese e konceptualizojnë si provë më të "fortë" apo më të "dobtë". Pra çka nënkuptohet me fuqi provuese?

Fuqia provuese apo pesha e provës përshkruan nëse provat janë bindëse. Por, pse një provë e bindë dikë e një tjetër jo? Kjo për faktin se provat mbështetën në konkluzionin përfundimtar që nxjerr gjtësi i fakteve.

Shembull: nëse kriminel i është parë duke u larguar me një makinë të kuqe, fakti që i pandehuri e ka një makinë të kuqe, a e mbështetë vërtet konkluzionin se ai është një kriminel? Mund të ketë mija njerëz me makina të kuqe. Nëse krejt ajo që dimë është se kriminel i ka pasur një makinë të kuqe dhe i pandehuri ka makinë të kuqe, probabiliteti që i pandehuri të jetë kriminel është 1 në njëmijë, ose 0.1%. Kuptohet, kjo nuk është provë shumë bindëse sepse ka probabilitet shumë të ulët që të jetë e saktë për të nënkuptuar se i pandehuri është kriminel.⁹ Andaj me të drejtë pohohet se disa prova e kanë fuqinë më të madhe karshi provave tjera, varësisht nga specifikat e rastit konkretë. Por, fuqia provuese e një prove shpeshëherë varet edhe nga përputhja e saj me provat e tjera.

CILA ËSHTË RËNDËSIA E TË PROVUARIT?

Në cilëndo procedurë që e zhvillojnë organet shtetërore, ku vendoset për interesat e qytetarit, nuk bënë që individit të pësojë konsekuenca të pakëndshme për shkak të paaftësisë, punës sipërfaqësore apo mosdijes së organit.¹⁰ Në këtë aspekt është tejet e rëndësishme që në procedurë gjyqësore të vërtetohet gjendja e plotë faktike, përmes provave të besueshme, në të cilat do të mbështetej vendimi gjyqësor. Prandaj në procedurë penale më shumë se në çdo procedurë tjetër duhet kushtuar rëndësi vërtetimit të plot të fakteve. Rëndësia e vërtetimit të drejt të çështjeve penale e duke u mbështetur në prova të besueshme është e dyfishtë: 1. Për faktin se kryerësve të këtyre veprave u kufizohen liritë dhe të drejtat, çka duhet pasur kujdes në çdo rast konkret me rastin e marrjes së vendimeve të tilla dhe 2. Për faktin së marrja e vendimeve duke u mbështetur në supozime, e në mungesë të provave të besueshme i kontribuon instalimit të një sistemi anarkik dhe krijon hendeqe të mëdha për arbitraritet nga ana e gjykatës dhe si e tillë përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Rëndësia jetike e të provuarit buron nga vetë parimet e procedurave penale bashkëkohore dhe aktet e tjera ndërkombëtare si Konventa Evropiane për Mbrojtën e të Drejtave të Njeriut¹¹, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, etj.¹² Këto dokumente kërkojnë që gjykimi të mbështetet në prova të besueshme, si parakusht për instalimin e një sistemi ligjor dhe demokratik. Krijimi i hapësirave të tilla, ku procedohet pa prova, duke u mbështetur në

⁹ Ibid., fq.69.

¹⁰ Ejup Sahiti, "Argumentimi në Procedurë Penale" Prishtinë, 2006, fq.93.

¹¹ Council of Europe, European Court of Human Rights, European Convention on Human Rights.

¹² Universal Declaration of Human Rights, Draft Committee, Paris, 1948.

supozime e prova irracionale përbën shkelje jo vetëm të ligjeve të brendshme, por edhe akteve ndërkombëtare dhe cenim të lirive dhe të drejtave elementare të njeriut. Andaj, në çdo rast konkret pretendimet e palëve duhet të mbështeten në prova, të cilat kanë një shkallë të lartë të besueshmërisë, në të kundërt akuzat e tilla do të mbeten të pabazuara dhe në kundërshtim me vet ligjin.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione: të provuarit në procedurë përbën një nga shtyllat kyç, për marrjen e një gjykimi të drejtë dhe kjo është një e vërtetë e pakontestueshme. Të provuarit paraqet një proces dinamik e tejet të ndërlikuar, në të cilin ndërveprojnë subjekte të ndryshme në procedurë. Marrja, ruajtja dhe administrimi i tyre në çështje penale, në çdo rast përbën një problematikë në vete, për faktin e ndjeshmërisë që kanë provat dhe qëndrimeve të kundërta të subjekteve procedural. Është e pakontestueshme, që procedimi me prova paraqet një shtyllë të fortë në instalimin e një sistemi ligjorë, duke zvogëluar mundësinë e vendimeve arbitrare e të pa provuara. Sot, të provuarit në procedurë është transformuar (ka evoluar), në masë të madhe falë zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror dhe në masë të madhe ka arritur të lehtësohet edhe vet procedura e të provuarit. Një nga përfundimet më të rëndësishme që mund të nxirret nga ky punim është se provat rrallëherë për të mos thënë kurrë, ofrojnë siguri të plot (100%) në vendimin e gjykatës. Gjykata që pretendon të konstatoj të vërtetën “absolute” është tepër idealiste. Pasi që gjykatat pothuajse asnjëherë nuk arrijnë të konstatojnë të vërtetën absolute. Në mënyrë që të jepet drejtësi dhe të zbatohet ligji, krejt çka është e mundur të arrihet është diçka më pak se e vërteta “absolute”, ose një drejtësi “relative”.

Është i padiskutueshëm fakti se sot fal zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë janë avancuar edhe mënyrat dhe mjetet e të provuarit e që shpeshherë në praktik mjerisht nuk aplikohen të arriturat e shkencës për të provuar faktet e ndryshme në procedurë. Aplikimi metodave bashkëkohore të të provuarit është duke u shfaqur mjaft problematik, sidomos në vendet e pazhvilluara dhe atyre në tranzicion dhe kjo për shkak të mos avancimit të duhur profesional të kuadrove, mosfinancimi i aparaturave tjera të domosdoshme për mbledhjen dhe ruajtjen e gjurmëve, etj. Një nga gjurmët më problematike për tu marr nga vendi i ngjarjes është gjurma e erës, gjurmë të cilën mund ta marrin dhe lokalizojnë vetëm disa nga shtetet më të zhvilluara për shkak të kostos së lartë që ka dhe përgatitjes së duhur të kuadrove profesionale.

Është e vërtetë e pakontestueshme se në mungesë të provave të besueshme dhe provave të marra në kundërshtim me ligjin, shumë fajtor mbesin të pandëshkuar për veprat e kryera e kjo si rezultat mos profesionalizmit dhe mungesës së gatishmërisë së institucioneve shtetërore për përgatitjen e kuadrove profesionale e kompetente, të cilët do ta kishin mundësin, që përmes metodave dhe mjeteve bashkëkohore të bëjnë gjetjen, mbledhjen, ruajtjen dhe dorëzimin e provave në gjykatë, në harmoni të plot me ligjin e të cilat padyshim do të ishin vendimtare në një gjykim penal.

Rekomandime: sido që të jetë edhe procesi i të provuarit ballafaqohet me problematika të shumta dhe do të ishte e rrugës që të bëhen disa rekomandime me qëllim të përmirësimit të tyre. Gjyqtaret, prokurorët, avokatët etj., duhet ta kuptojnë potencialin e provave, përmes krijimit të një fjalori të përbashkët konceptual, apo krijimin e një standardi unik për të përshkruar provat. Kjo, për faktin që gjykata në çdo rast do t'i përafrohej sa më shumë të vërtetës së plot. Rekomandim tjetër do të ishte që në shqyrtimin kryesorë në gjykatë të mos procedoheshin prova të parëndësishme dhe kundërligjore, të cilat vetëm do ta zvarritnin procesin dhe do ta pengonin arritjen deri tek e vërteta. Do të ishte mirë që në mes të

subjekteve procedurale të krijohej një kornizë e përbashkët konceptuale lidhur me ekzaminimin e provave në mënyrë kritike dhe për të debatuar mbi cilësitë e këtyre provave. Kjo, do të kontribuonte që gjykatat në të ardhmen t'i përafrohen edhe më shumë gjetjes të së vërtetës në procedurë.

Rekomandohet që para shqyrtimit kryesorë të çështjes të shikohen paraprakisht provat e propozuara nga subjektet procedurale në atë mënyrë që provat jo relevante, të pa mbështetshme dhe të kundërligjshme të mos procedohen, për shkak se vetëm do ta përfshinin gjykatën në konfuzion, do të tej-zgjatej procedura dhe eventualisht, do ta përfshinin gjykatën në lajthitje me rastin e marrjes se një vendimi përfundimtar.

Përgatitja e duhur e kuadrove, të cilët do të ishin më profesional me rastin e marrjes, ruajtjes dhe dorëzimit të provave, si parakusht për zhvillimin e një procesi gjyqësor efektiv dhe në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi, përbën një domosdoshmëri të kohës kur marrim parasysh format e sofistikuar të kriminalitetit në kohën moderne.

Rekomandohet që shoqëritë dhe shtetet bashkëkohore t'i kushtojnë rëndësi të veçantë aplikimit të mjeteve dhe metodave bashkëkohore, njëkohësisht t'i shfrytëzojnë të arriturat e shkencës dhe teknologjisë, si burim fillestar i provave dhe informacionit të besueshëm, që më pas të mund të përdorshin si argumentues të besueshëm në proceset gjyqësore.

REFERENCAT

1. Council of Europe, European Court of Human Rights, European Convention on Human Rights.
2. Criminal Justice- Degrees Guide, "10 Most incriminating types of Evidence", <http://ëëë.criminaljusticedegreesguide.com/features/10-most-incriminating-types-of-evidence.html>.
3. Ejup Sahiti, "Argumentimi në Procedurë Penale", Prishtinë, 2006.
4. Ejup Sahiti & Rexhep Murati, "E drejta e Procedurës Penale", Prishtinë, 2013.
5. Ejup Sahiti & Rexhep Murati & Xhevdet Elshani, "Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës", Komentarë, Botimi 1, Prishtinë, 2014.
6. Jon Simbert, "Parimet e Provave", Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2014.
7. Paul Bergman, J.D, UCLA, Laë School Professor, "Relevant Evidence in Criminal Trials", <http://www.nolo.com/legal-encyclopedia/relevant-evidence-criminal-trials.html#>.
8. Universal Declaration of Human Rights, Draft Committee, Paris, 1948.